

fshatin Obri e Epërme/Gornje Obrinje deri më 5.10.1998, kur vëllai i Afrimit e mori dhe e varrosi trupin e tij në varrezat në *Mëhallën Kiqina*, në fshatin Bajicë/Banjica. Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Afrimit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Bajicë/Banjica.

**Burimet:** deklarata F.K, FDH-31840; deklarata I.D, FDH-33503; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor - dhjetor 1998, 49-50, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

### Metush (Sejdi) Shapeta

(1945, shqiptar nga Korrotica e Epërme/Gornja Koretica, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor ndërtimtarie, një fëmijë)

Metushi ka jetuar në Shkup [Maqedoni], por në fillim të viteve të nëntëdhjeta u kthye në Kosovë. Qëndronte te familja e motrës, Mine Karaxha, e cila e kishte shtëpinë në Çikatovë të Vjetër/Staro Čikatovo [Glllogoc/Glogovac]. Në fillim të muajit maj të vitit 1998, Mina me familje, si dhe bashkëfshatarë të tjerë, e braktisën fshatin. Shkuan në Obri të Epërme/Gornje Obrinje, te vajza e Mines. Metushi ka mbetur në shtëpi në Çikatovën e Vjetër/Staro Čikatovo. Po atë ditë, policia serbe, e cila ishte e përqendruar në fabrikën e *Ferronikelit*, e ka bombarduar fshatin. Një predhë e ka qëlluar shtëpinë ku gjendej Metushi duke e shkakuar shpërthimin e zjarrit. Metushi u plagos rëndë. Ashtu të plagosur, e ka gjetur Bexheti, nipi i tij, i cili ishte pjesëtar i UÇK-së. Bexheti së pari e barti Metushin në ambulancën e UÇK-së, e pastaj në **Obri të Epërme/Gornje Obrinje**. Atje, Metushi i kaloi disa muaj të ardhshëm. Kur, më 18.09.1998, të gjithë familjarët e Mines vendosën të largoheshin nga fshati dhe të strehoheshin në Tërstenik/Trstenik, Metushi sërish vendosi të mos largohej, por të rrinte në shtëpi. Ka gjetur vdekjen më **25.09.1998**, kur forcat serbe e bombarduan fshatin. Trupin e pajetë të Metushit e kanë zbuluar disa të afërm të tij. Ata e kanë varrosur në varrezat e Obrisë së Epërme/Gornje

Obrinje më 30.09.1998. Atje, ai prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata S.K, FDH-35576; *26 Burned Houses, Extent of Casualty-Toll Still Unknown, at Poklek Village*, pasqyra e lajmeve, KIC, 2.06.1998, FDH-29304.

### Fazli (Rame) Deliu

(10.03.1908, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glllogocit/Glogovac, pensionist, nëntë fëmijë)

### Zeqir (Januz) Deliu

(20.04.1954, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, shtatë fëmijë)

### Adem (Salih) Deliu

(25.02.1965, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glllogocit/Glogovac, metalurg, një fëmijë)

Kur serbët e vendosën kontrollin mbi fshatin Likoc/Likovac më 19.09.1998, fshatarët e Obrisë së Epërme/Gornje Obrinje, si dhe refugjatët që ishin strehuar tek ata, e braktisën fshatin nga frika se do të sulmoheshin nga forcat serbe. U strehuar në pyjet përmbi fshatin e tyre. I ngritën tendat nga najloni. Burrat shkonin natën në fshat për të sjell ushqime. Në datën 22.09.1998, forcat serbe i nisën sulmet mbi fshatrat e rajonit të *Kosmaçit/Kosmaç*. Banorët e Obrisë së Epërme/Gornje Obrinje u zhvendosën në pyjet në mes të fshatrave Vrboc/Vrbovac, Qirez/Ćirez dhe Likoshan/Likošane. Atje gjendeshin me mijëra refugjatë. Numri më i madh i tyre u strehua në vendin e quajtur *Fusha e Mollës/Jabukovo polje*. Në mbrëmje, forcat serbe iu afruan të zhvendosurve. Familja e Imer Deliu, pjesëtarit të UÇK-së, nga frika se do të keqtrajtohej ngase një anëtar i saj i luftonte forcat serbe, vendosi që të kthehej në pyll përmbi fshatin e Obrisë së Epërme/Gornje Obrinje. Në mesin e familjarëve ishin edhe Zeqiri dhe Ademi. E ngritën tendën te vendi i quajtur *Zabeli i Rrënjëve/Koreniti šumarak*, i cili ishte një kilometër larg *Mëhallës Deliu*. Në tendë qëndronin gratë, fëmijët dhe pleqtë, përderisa burrat qëndronin në mëhallë gjatë natës.

Në datën **26.09.1998**, nga ora 14:00,